

Modeli Shqiptar I Tregut

Ardian Haci – Komisioner, ERE

Karakteristikat e Tregut

- Popullsia e Shqiperise: 3 114 000 banore
- Kapaciteti I instaluar: 1 684 MW
- Mixi I Gjenerimit: 98% e prodhimit te brendshem nga hidrocentralet dhe 2% nga Termocentralet
- Deri tani kemi vetem nje konsumator te kualifikuar. Qe nga 1 Janari 2008, ERE I ka dhene te drejten per tu kthyer ne konsumatore te kualifikuar te gjithe konsumatoreve jofamiljare

Modeli Shqiptar I Tregut

HARTIMI

- Kerkese e Ligjit nr.9072 date 22.05.2006 (neni 53)
 - ERE dhe pjesemarresit e tjere te sektorit ne bashkepunim me konsulencen hartuan Modelin
 - Ministria e Industrise dhe Energjitikes paraqiti draftin ne Keshillin e Ministrave

MIRATIMI

- Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.628 date 3.10.2007
 - “ Per miratimin e Modelit Shqiptar te Tregut te Energjise Elektrike “

Modeli Shqiptar I Tregut

- Pjesemarresit e tregut
- Marredheniet ndermjet pjesmarresve te tregut
- Struktura e Tregut

Pjesmarresit e Tregut

- Operatori I Sistemit te Transmetimit (OST)
 - Është shoqeri e pavarur shteterore qe kryen këto funksione:
 - Operimin e rrjetit te transmetimit nga pikpamja fizike (posedim, mirembajtje dhe zgjerim) (ORrT)
 - Operatorin e Sistemit nga pikepamja e dispecerimit (OS);
 - Operatorin e Tregut (duke siguruar qe informacioni per likuidimin e kontratave është i disponueshem, qe me pas mund te sherbeje si nje burse e energjisë elektrike).

Pjesmarresit e Tregut

- Gjenerimi Publik (KESH Gen) – eshte nje strukture brenda KESH me license per prodhimin e energjise elektrike.
 - KESH- Gen I shet Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike sipas kerkesave te tij me çmim te miratuar nga ERE-ja. Shitja behet sipas marrëveshjeve vjetore ose per periudha te tjera sic miratohen nga ERE

Pjesmarresit e Tregut

- Prodhues te vegjel jane centralet e vegjel gjenerues te energjise elektrike, qe lidhen me sistemin e shpërndarjes.
 - PVE-te licensohen per te shitur energji elektrike me cmime te rregulluara te Furnizuesi Publik me Shumice ose ne tregun e eksportit, te Klientët e Kualifikuar, Furnizuesit e Kualifikuar ose Tregtuesit me terma komerciale te rena dakort ose te miratuara nga ERE-ja nese nuk mund te arrihet nje marrëveshje

Pjesmarresit e Tregut

- Prodhuesit e Pavaruar te Energjisë Elektrike (PPE) - jane prodhuesit e pavaruar qe lidhen direkt ne sistemin e transmetimit.
 - PPE-te licensohen nga ERE-ja dhe mund te shesin kapacitete ose energji tregut te eksportit, OSSH-se (per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes), Klienteve te Kualifikuar, Furnizuesve te Kualifikuar, Tregtareve me cmime tregu ose Furnizuesit Publik me Shumice me çmim kontrate te miratuar nga ERE-ja.

Pjesmarresit e Tregut

- **Furnizuesit e Kualifikuar (FK)**- jane furnizuesit vendas ose te huaj te licensuar nga ERE-ja, te cilet mund te blejne energji nga jashte, nga PVE-te ose nga PPE-te per t'jua shitur Klienteve te Kualifikuar.
 - PVE-te dhe PPE-te duhet te licensohen qe te behen Furnizues te Kualifikuar, nese ata vendosin qe t'i shesin direkt energji elektrike Klienteve te Kualifikuar.

Pjesmarresit e Tregut

- **Tregtuesit** - Jane subjekte private vendase ose te huaja, qe blejne dhe shesin energji elektrike me shumice. Tregtuesit licensohen nga ERE-ja.
 - ERE-ja do te siguroje qe licensat dhe procedurat e licensimit per Tregtuesit jane te thjeshta, jo-diskriminuese dhe nuk krijojne pengesa te panevojshme per hyrjen e Tregtuesve ne tregun shqiptar.

Pjesmarresit e Tregut

- **Furnizuesi Publik me Shumice** – eshte nje entitet ose njesi e KESH e cila ble energji elektrike nga KESH Gen, PVE, PPE dhe Tregtuesit sipas kerkeses se klienteve tarifore, dhe i shet energji elektrike Furnizuesit Publik me Pakice.
 - Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesine qe te sherbeje si sigurues i alternatives se fundit per te gjithë klientët

Pjesmarresit e Tregut

- **Operatori i Sistemit te Shpërndarjes (OSSH) -** OSSH-ja zoteron, miremban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes ne te gjithe Shqiperine.
 - OSSH-ja eshte pergjegjese per blerjen e energjise elektrike per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes. OSSH-ja mund ta bleje kete energji nga cdo pjesmarres tregu me cmime tregu.
 - Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve te shpërndarjes qe sigurohen nga OSSH-ja rregullohen nga ERE-ja.

Pjesmarresit e Tregut

- **Furnizuesi Publik me Pakice** –eshte entiteti qe kryen funksionin e blerjes se energjise nga Furnizuesi Publik me Shumice dhe qe I shet energji elektrike konsumatoreve tarifore. Furnizuesi Publik me Pakice mund te jete pjese e te njejtës kompani si OSSH-ja.
 - Furnizuesi Publik me Pakice i shet energji elektrike me tarifa te rregulluara nga ERE-ja vetem klienteve tarifore

Pjesmarresit e Tregut

- Furnizuesi Publik me Pakice blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice me tarifa te miratuara nga ERE-ja.
 - Furnizuesi Publik me Pakice eshte pergjegjes per reduktimin e mosarketimeve nga klientet tarifore sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja.

Pjesmarresit e Tregut

- **Klientet Tarifore** - Kliente tarifore jane ata kliente qe blejne energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakice me tarifa te rregulluara nga ERE-ja.
- **Klientët e Kualifikuar** - Klientet e Kualifikuar jane kliente qe mund te blejne energji elektrike nga PVE-te, PPE-te dhe Furnizuesit e Kualifikuar sipas ligjit dhe procedurave te miratuara nga ERE-ja.

Pjesmarresit e Tregut

Çdo klient është i lirë të zgjedhë të mbetet klient tarifor apo të bëhet i kualifikuar nëse plotëson kushtet përkatëse.

- ERE-ja harton rregulla për të përcaktuar kushtet në të cilat një klient mund të kthehet në kategorinë e klienteve tarifore pasi ka zgjedhur të bëhet klient i kualifikuar.

Pjesmarresit e Tregut

- **Rregullatori i Pavarur (ERE)**

ERE-ja është përgjegjëse :

- per percaktimin e te drejtave dhe detyrimeve respektive te pjesëmarrësve te tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese qe sigurojne aksesin e paleve te treta
- per te siguruar kontroll rregullator per tregun e energjisë elektrike

Pjesmarresit e Tregut

ERE-ja është përgjegjëse :

- Ne përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike, ERE-ja do t'i kerkoje të licensuarve të veprojnë në një mënyrë të tillë që të sigurojnë sigurinë e furnizimit afat-shkurter dhe afat-gjate. ERE-ja kërkon nga Furnizuesi Publik me Shumice ekzekutimin e marrëveshjeve të blerjes së energjisë elektrike për aq kohë sa ato kërkesa janë në përputhje me strategjinë kombëtare të hartuar nga Këshilli i Ministrave dhe çdo marrëveshje privatizimi.

Pjesmarresit e Tregut

ERE eshte pergjegjese :

- Baza ligjore per ushtrimin e këtyre pergjegjesive nga ERE-ja sigurohet nga ligji nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

Marrëdhëniet mes pjesmarrësve të tregut

- Marrëdhëniet dhe roli i pjesmarrësve të tregut në operimin fizik të Modelit të Tregut bazohet në kontrata dypaleshe mes pjesmarrësve të ndryshëm në përputhje me përcaktimet e mëposhtme .
 - ❖ Tregu I Rregulluar
 - ❖ Tregu I Parregulluar

Marredheniet Kontraktuale

- **Tregu I rregulluar** – marredheniet kontraktuale midis
 - Ndermjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice (te pakten me qellim per berjen transparent te cmimeve qe do te vendose KESH Gen-i ndaj Furnizuesit Publik me Shumice)
 - Ndermjet OST-se dhe pjestareve te tjere te tregut per transmetimin dhe shërbimet qe lidhen me te
 - Ndermjet OSSH-se dhe pjestareve te tjere te tregut per shperndarjen dhe shërbimet qe lidhen me te


Marredheniet Kontraktuale

- Tregu I rregulluar
 - Ndermjet PVE-ve/PPE-ve dhe Furnizuesit Publik me Shumice;
 - Ndermjet Furnizuesit Publik me Pakice dhe klienteve te tij tarifore;
 - Ndermjet KESH Gen-it dhe partnereve te importit per shkembimet e energjise;
 - Ndermjet OST-se dhe KESH Gen-it, PVE-ve, PPE-ve dhe Tregtuesve, per humbjet e transmetimit dhe Shërbimet Ndhimese


Marredheniet kontraktuale

- Tregu I parregulluar – marredheniet kontraktuale ndermjet
 - Furnizuesve te Kualifikuar dhe Klienteve te Kualifikuar
 - PVE-ve/PPE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar dhe Tregtuesve
 - Furnizuesit Publik me Shumice dhe Tregtuesve
 - OSSH-se dhe Tregtuesve per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes


Fluksi i Energjise Elektrike



Marreveshjet e Lidhjes dhe te Sherbimit te Transmetimit perfshire Sherbimet Ndhimese (te siguruara nga OST)



Marreveshjet e Furnizimit me Energji



Kerkesat e BE

- Ndarja
 - OST-ja ligjerisht, funksionalisht dhe financiarisht e ndare
 - OSSH-ja (perfshin funksionin e Furnizuesit Publik me Pakice). Funksionalisht, financiarisht dhe ligjerisht e ndare nga monopoli
 - Shperndarja dhe Furnizuesi Publik me Pakice jane funksionalisht dhe financiarisht te ndara nga njera tjetra por jo ligjerisht te ndara.

Kerkesat e BE

- Garantohet aksesimi i paleve te treta ne rrjetin e transmetimit dhe te shperndarjes
- Metodologjite e tarifave per aksesin ne rrjetin e transmetimit dhe te shperndarjes jane aprovuar dhe bere publike
- OST-ja dhe OSSH-ja jane pergjegjese per humbjet ne rrjetin e transmetimit dhe te shperndarjes
- Tregu plotesisht i hapur per klientet jofamiljare qe nga 1 Janar, 2008

Faleminderit!